



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Arsimit Kulturës, Sportit Rinisë, Trashigimisë Kulturore, Dhënies së Titujve
dhe Emërtimeve

Nr 4657



Fushë-Arrëz, më 19.12.2024

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 33 datë 26 / 11 / 2024, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetin Vjetor për vitin 2025"

Analiza ligjore: Hartimi i projektit buxhetor afatmesëm 2025-2027 është bërë bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin 68/2017 datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhezimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV", udhezimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", dhe anekset plotësuese.

Hartimi i Buxhetit për vitet 2025 - 2027 është kryer pas një pune gjithëpërfshirëse të administratës së Bashkisë, anëtareve të Këshillit të Bashkisë, Njësise Administrative, komunitetin e biznesit, komunitetin e banorëve, si dhe aktore të ndryshëm të shoqërisë civile. Përgatitja e buxhetit është paraprirë nga dëgjesa dhe komunikim me publikun, Promovimi i transparencës në krijimin e instrumenteve financiarë ndaj komunitetit përbën një detyrim ligjor për organet shtetërore, por në fakt është edhe një detyrim moral që kanë institucionet e qeverisjes vendore ndaj komunitetit që

përfaqësojnë. Hartimi i Buxhetit u përfshi në një cikël të plotë buxhetimi sipas kërkesave ligjore, duke i ndjekur të gjitha hapat të përcaktuara në ligj. Administrata e Bashkisë është bazuar kryesisht ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe ligjin nr.146/2014 “Për konsultimin publik”, përveç akteve ligjore dhe nënligjore teknike dhe specifike të sipërcituara të domosdoshëm për hartimin e këtij instrumenti financiar.

Situata aktuale e funksionit: Përmes fondeve të alokuara në Arsimin bazë përfshirë arsimin parashkollor, synohet 1. ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar. 2. organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.. Në këtë drejtim bashkia ka punuar gjatë vitit në objektiva si: Bashkia ofron kushte për përmirësimin e arsimit bazë (9-vjeçar) dhe parashkollor. Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është përdorur nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunitetit për arsimin bazë përfshirë parashkollorin.

Përmes fondeve të alokuara në Arsimin e mesëm të përgjithshëm, synohet ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar në arsimin e mesëm të përgjithshëm. Në këtë drejtim bashkia ka punuar gjatë vitit në objektiva si: Bashkia ofron kushte për përmirësimin e arsimit të përgjithshëm (mesëm). Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është përdorur nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunitetit për arsimin e mesëm.

Situata financiare: Buxheti për Programin e Arsimit bazë përfshirë arsimin parashkollor për vitin 2025 do të jetë në shumën 60.591.000 lekë, prej të cilave 93.4% janë për paga dhe sigurime shoqërore, me një rritje prej 4.229.000 lekesh në krahasim me 2024 dhe pjesa tjetër 6.6% për shpenzime operative dhe mirëmbajtje.

Buxheti për Programin e Arsimit të mesëm të përgjithshëm për vitin 2025 do të jetë në shumën 6.683.000 lekë, me një rritje të lehtë të pagat dhe sigurimet shoqërore prej 9.000 lekësh. 5.913.000 janë për paga dhe sigurime shoqërore dhe pjesa tjetër 770.000 për shpenzime operative dhe mirëmbajtje.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Arsimit e ka relatuar përpara komisionit për Projekt Buxhetin 2025

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Arsimit Kulturës, Sportit Rinisë, Trashigimisë Kulturore, Dhënies së Titujve dhe Emërtimeve dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e Financës ose Drejtoria e Arsimit për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: Programi Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxheti Vjetor për vitin 2025 impakton jetën të gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e të gjithë territorit të bashkisë Pukë

A është objekt i konsultimit publik: Janë mbajtur dëgjuesat publike në Fushë Arrëz, në Njësitë Administrative Qafë Mali, Iballë, Fierzë dhe Blerim me banorët e të gjitha Njësitë Administrative, Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit Komunitarë, përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit, etj.

Dëgjesat janë mbajtur sipas kalendarit të dëgjesave të publikuar në rregjistrin e konsultimeve me publikun. Është publikuar edhe përmbledhja e rekomandimeve të qytetarëve.

Numri i pjesëmarrësve në konsultime ishte 108 persona, nga të cilët 32 gra dhe vajza (20%) dhe numri i rekomandimeve ishte 54.

Komisioni i Arsimit Kulturës, Sportit Rinisë, Trashigimisë Kulturore, Dhënies së Titujve dhe Emërtimeve, i mbledhur me datën 19.12.2024, shqyrtoi projekt vendimit nr. 35 datë 26/12/2024, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetin Vjetor për vitin 2025" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Beqir Marku 
(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Tereze Dema 
(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit

Datë 19.12 2024